


Për momentin nuk ka dëshmi se kafshët – kafshët shtëpiake, si qentë apo macet mund të infektohen me koronavirusin e ri.

Megjithatë, mirë është që t'i lani duart edhe pas kontaktit me kafshët tuaja shtëpiake.

Kjo ju mbron nga bakteriet si E. coli dhe Salmonella që mund të përcillen nga kafshët shtëpiake tek njeriu.

***A mund ta përcjellin
koronavirusin e ri
(2019-nCoV) kafshët
shtëpiake?***



#2019n-CoV

Koronavirusi i ri (2019-nCoV) mund të prekë persona nga të gjitha grupmoshat.

Personat më të moshuar dhe personat që vuajnë nga sëmundje kronike (si astma, diabeti, sëmundjet e zemrës) me sa duket janë më të prirur për të zhvilluar sëmundje më të rëndë nga virusi.

OBSH i këshillon të gjithë njerëzit e të gjitha grupmoshave që të ndërmarrin masa për tu mbrojtur nga virusi, si për shembull praktikimi i higjienës së duarve dhe higjienës respiratore.



#2019n-CoV

***A i prek koronavirusi
personat më të moshuar,
apo edhe më të rinjtë janë
të rrezikuar nga
infeksioni?***



Jo, antibiotikët nuk veprojnë tek viruset, por vetëm tek bakteriet.

Koronavirusi i ri (2019-nCoV) është virus, prandaj për parandalimin dhe mjekimin e tij nuk duhen përdorur antibiotikë.

Por, nëse jeni hospitalizuar për shkak të 2019-nCoV, mund të duhet të pranoni antibiotikë për shkak të ko-infeksionit me bakterie.

***A janë efikas antibiotikët
në parandalimin dhe
mjekimin e koronavirusit
të ri?***



#2019n-CoV



Deri më sot nuk është rekomanduar ndonjë ilaç specifik për parandalim ose mjekim të koronavirusit të ri (2019-nCoV).

Megjithatë, personat e infektuar me virusin duhet të pranojnë përkujdesje adekuate për lehtësimin dhe mjekimin e simptomave, ndërsa ato që do të zhvillojnë formë të rëndë të sëmundjes duhet të pranojnë mjekim adekuat.

Po hulumtohen disa trajtime specifike të cilat do të testohen me analiza klinike. OBSH bashkë me disa partnerë të saj, ndihmon në përhshpejtimin e angazhimeve për hulumtim.



#2019n-CoV

A ekzistojnë ilaçe specifike për parandalim ose mjekim të koronavirusit të ri?



Ende nuk ka të dhëna të cilat mund të vërtetojnë se Tamiflu (oseltamivir) mund të përdoret për ta mjekuar koronavirusin e ri (2019-nCoV).

OBSH po punon me hulumtuesit dhe mjekët në mbarë botën për të zbuluar mënyrat e për t'i analizuar mënyrat e mundshme të trajtimit të virusit. Kjo përfshin edhe analizat për të parë nëse barnat ekzistuese antivirale mund të veprojnë tek ky virus. Megjithatë, këto analiza janë në fazë të hershme dhe nuk ka rekomandime shtesë.

***A mund të përdoret
Tamiflu (oseltamivir) për
të mjekuar koronavirusin
e ri (2019-nCoV)?***



#2019n-CoV




Jo. Vaksinat ekzistuese kundër pneumonisë nuk sigurojnë mbrojtje kundër koronavirusit të ri (2019-nCoV).

Virusi është i ri dhe ndryshe dhe për atë nevojitet një vaksinë e veçantë. Hulumtuesit po mundohen të zhvillojnë vaksinë kundër 2019-nCoV, ndërsa OBSH mbështet të gjithë angazhimin e tyre.

Edhe pse vaksinat kundër pneumonisë nuk janë efikase kundër 2019-nCoV, ato rekomandohen kundër sëmundjeve respiratore si mbrojtje për shëndetin Tuaj.

A mund të mbrojnë nga koronavirusi i ri (2019-nCoV) vaksinat ekzistuese kundër pneumonisë?



#2019n-CoV

Personat që pranojnë pako nga Kina,
nuk janë të ekspozuar ndaj rrezikut
për tu sëmurë nga koronavirusi i ri
(2019-nCoV).

Nga analizat dhe njohuritë paraprake,
e dimë që koronaviruset nuk
mbijetojnë gjatë tek gjësendet, siç
janë letrat dhe pakot.

*A janë të sigurt letrat dhe pakot e
ardhura nga Kina?*

